




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivered	25.08.2022	viti god year	2022
Organ / Njësia Organ / Jedinica Orgj / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	4983/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.641/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti - kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.641/2022 të datës 21.07.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi fshati [redacted] Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit/Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.08.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.641/2022 e datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

### A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Komunën e Ferizajt sipas Akt emerimit të fundit të datës 01.07.2011 të cilin e mban, në pozitën “Inspektor i njësisë së ndërtimtarisë” në Drejtorinë e Inspektionit, mirëpo sipas Vendimit me numër 01Nr.68/14 të datës 26.01.2014 i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Ferizajt, i njëjti është transferuar përhershëm nga Drejtoria e inspeksionit në atë të Urbanizmit dhe Mjedisit pas shuarjes së Drejtorisë së Inspeksionit në këtë komunë. Me datën 26.01.2022, ankuesi me kërkesën e fundit i është drejtuar Zyrës së Personelit në Komunën e Ferizajt lidhur me ngritjen e koeficientit pas disa kërkesave dhe ankesave të vazhdueshme për të njëjten qështje, ndërsa me datën 28.02.2022, ka parashtruar ankesën me numër 02-113/01-0009192/22 për tek Drejtoria e Administratës së Përgjithshme e Komunës së Ferizajt, lidhur me diskriminimin në pagë si dhe ngritjen e koeficientit.

Komuna e Ferizajt konkretisht Zyra e Burimeve Njerezore, me datën 05.07.2022, e ka njoftuar ankuesin se bazuar në legjislacionin në fuqi, i njëjti duhet ti drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

I pakënaqur me përgjigjen nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajt, ankuesi me datën 19.07.2022 përmes Postës së Kosovës, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4226/2022, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datën 21.07.2022, lidhur me ngritjen e koeficientit dhe diskriminimin në pagë.

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 25.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Ferizajt. Ndërsa Këshilli, me datën 15.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga ky institucion.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 4226/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 05.07.2022 nga Zyra e Burimeve Njerëzore e Komunës së Ferizajt për ankuesin; Ankesën e ankuesit të datës 28.02.2022 drejtuar komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësve të komunës së Ferizajt; Kërkesën e datës 26.01.2022 nga ankuesi drejtuar zyrës së personelit dhe drejtorisë së administratës së përgjithshme në komunën e Ferizajt; Përgjigjen në kërkesën e ankuesit të datës 04.02.2021 nga zyra e personelit të komunës së Ferizajt; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 15.08.2022 nga Komuna e Ferizajt së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me numër nr.254/2004-13 të datës 02.01.2004; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me numër 02Nr.266/42059 të datës 29.12.2004; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me numër 02Nr.266 të datës 28.12.2005; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me numër 02Nr.011 të datës 07.05.2007; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me numër 02Nr.201 të datës 01.04.2008; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me numër 02Nr.212 të datës 27.02.2009; Letër emërimit me numër No.19.06 të datës 02.01.2002 për ankuesin; Përgjigjen në ankesë me numër 01nr.116-51928 të datës 01.08.2016; Formularin PDP lidhur me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e inspektorit të njësisë së ndërtimitarisë të datës 29.06.2012; Vendimin me numër NR.02-116-51928 të datës 08.06.2016; Paralajmërimin-qortimin me shkrim për shkelje disiplinore të ankuesit të datës 26.05.2016; Diplomën e ankuesit me numër 26-105/15.06.1980 të datës 15.06.1980; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.07.2011; Ankesën e ankuesit të datës 18.05.2016 për komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave; Letër emërimit e ankuesit të datës 01.11.2000; Letër emërimit me numër Nr.14.45 të datës 13.01.2003 për ankuesin; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me numër 02.Nr.201 të datës 26.06.2008; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me numër 236/2009 të datës 01.07.2009; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit me numër 236/2010 të datës 04.05.2010; Letrën e emërimit të ankuesit të datës 02.01.2001; Letër emërimit me numër No.19.06 të datës 02.01.2001 për ankuesin; Letrën e emërimit me numër Nr.14.45 të ankuesit të datës 01.07.2002; Listën me pozitat e inspektorëve në komunën e Ferizajt dhe listën e pagave për muajt maj, qershor dhe korrik të vitit 2022 për ankuesin; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.07.2014 dhe Vendimin me numër 01Nr.68/14 të datës 26.01.2014 nga Kryetari i Komunës së Ferizajt lidhur me transferin e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, ka analizuar bazën ligjore konkretisht duke ju referuar dispozitave 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, ndërsa nenin 3 paragrafi 1 Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil"*, po ashtu ka analizuar dispozitat e nenit 9 paragrafin 1 Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës"*, rrjedhimisht mbi bazë të kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës, si rrjedhojë duke i'u referuar provave të lëndës, konstatohet që ankuesi realizon pagë të përcaktuar sipas aktit të themelimit të marrëdhënies së punës gjegjësisht sipas Akt emërimit të datës 01.07.2011 me koeficient gjashtë (6), në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit.

Nga shqyrtimi i të gjitha provave të lëndës, Kolegji nuk ka gjetur ndonjë kontratë apo akt tjetër administrativ të organit të punësimit për harmonizim të koeficientit të ankuesit po ashtu nuk ka gjetur ndonjë veprim juridik që organi i punësuar të ketë ndërmarrë lidhur me çështjen e ankuesit, sepse për të realizuar ngritjen apo harmonizimin e koeficientëve *"Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat"*, siç parashihet me nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil. Andaj çdo ndryshim në këtë rast duhet të jetë i miratuar nga ministria përgjegjëse për administratë publike dhe ministria përgjegjëse për financa, ndërsa në rastin konkret të ankuesit përveç që nuk kemi ndërmarrje të veprimeve nga autoriteti punëdhënës nuk kemi miratim nga ministritë gjegjëse.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për ngritjen e koeficientit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka analizuar shkresat e lëndës të ofruara nga organi i punësimit lidhur me dëshminë profesionale të ankuesit, ka konstaturuar se i njëjti ka të përfunduar vetëm shkollimin e mesëm në Shkollën e Mesme Ekonomike në Ferizaj sipas diplomës me Nr.prot.26-105/15.06.1980 të datës 15.06.1980 e jo edhe shkollimin-nivelin universitar siç duhet të jetë përgatitja profesionale tashmë me konkurs për pozitën e ankuesit, andaj meqenëse ankuesi nuk posedon dëshmi lidhur me përvojën profesionale përveç kryerjes së shkollimit të mesëm edhe pretendimet e tij lidhur me ngritjen e koeficientit janë të pabazuara dhe jo ligjore.

Nga të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se përderisa nuk kemi veprime sipas dispozitave të lartcekura, ankuesi do të realizoj pagë sipas aktit të themelimit të marrëdhënies së punës dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.641/2022, datë 25.08.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

